



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1163/2 Prot.

Tiranë, më 13.12.2023

V E N D I M

Nr. 249 , Datë 13 . 12 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 233, datë 27.10.2023, e znj. G.H kundër Bashkisë Dimal, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 10.11.2023, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Është emëruar pranë Bashkisë Dimal me Urdhrin nr. 196, datë 18.01.2021 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” në pozicionin specialist jurist pranë Drejtorisë Juridike, Prokurimeve, Protokoll-Arkivës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Me datë 06.10.2022, për shkak të ristrukturimit me urdhër të titullarit me shkrirjen e Drejtorisë Juridike është transferuar në detyrë me Urdhrin nr. 2848, datë 06.10.2022 dhe paralelisht duke qenë se vendi i punës është shpallur vakant nga njësia përgjegjëse e institucionit. Ka aplikuar nga jashtë shërbimit civil për pozicionin Specialist Jurist pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, duke u shpallur fituese në faqen zyrtare të AKPA-s.

Për shkak të ndryshimit të pozicionit të punës, përshkrimi i punës nuk ka pësuar ndryshime, ka vijuar punën normalisht me të njëjtat detyra dhe kompetenca me të cilat ka punuar dhe më parë. Detyrat ishin të ndara, të mirë përcaktuara, bazuar në përshkrimin e punës i cili është bërë i

¹ Për shkak të kundërshtimit të urdhrave të paligjshëm të eprorit.

njohur në fillim të marrëdhënies së punës më 18.01.2021 dhe në respektim të Vendimit nr. 1043, datë 31.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Ura Vajgurore”.

Ankuesja ka vijuar rregullisht marrëdhënien e punës, pa marrë asnjë masë disiplinore, duke i kryer detyrat me korrektësi. Gjithashtu nga titullari i institucionit sigloheshin të gjitha detyrat që ishin në kompetencë të pozicionit të punës.

Me datë 01.09.2023 merr dijëni për masën disiplinore “Vërejtje” të datës 30.08.2023, me iniciativë të eprorit direkt, Drejtor i njësisë përgjegjëse, pa filluar procedimin disiplinor.

Me datë 06.09.2023 është njohur me shkresën nr. 2803, datë 06.09.2023 “Propozim për masë disiplinore” të iniciuar nga Inspektor Pritje për “mos përmbushje detyrash”. Me datë 13.09.2023 ka depozituar ankimin administrativ ndaj Bashkisë Dimal.

Në datë 14.09.2023, merr dijëni mbi njoftimin për fillimin e procedimit disiplinor, administruar me nr. 2905/3, datë 14.09.2023.

Me datë 02.10.2023 merr dijëni për vendimin e Komisionit Disiplinor me nr. 2905/10, datë 27.09.2023 dhe Urdhrin e lirimimit nga shërbimi civil me n.r. 3112, datë 29.09.2023. Të dy aktet të cilat sollën largimin nga detyra janë të pamotivuara, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mos përmbushje të detyrës nga ana e saj.

Bazuar në rrethanat e fakteve të parashtruara më sipër, nga Bashkia Dimal janë kryer veprime/mosveprime të cilat kanë sjellë largimin nga detyra të ankueses për shkaqe të pamotivuara.

Ndërmjet ankueses dhe titullares së institucionit është krijuar situatë konfliktuale në janar 2023, si pasojë e kundërshtimit të një urdhri të paligjshëm (kërkesë për rinovim kontrate të një objekti me qira, të cilin ajo e ka argumentuar si veprim në kundërshtim me ligjin) për të cilin ka informuar drejtpërdrejtë Kryetaren e Bashkisë. Kjo situatë ka vijuar deri në datë 29.08.2023, moment në të cilin Këshilli Bashkiak ka miratuar dhënien me qira të pronës shtetërore.

Nga ana tjetër, si person përgjegjës për monitorimin e kontratës, në përfundim të afatit, pasi është ezauruar procedura e njoftimit për lirim vullnetar të pronës, me datë 21.07.2023 ka përpiluar urdhrin e ngritjes së grupit të punës për marrjen në dorëzim të pronës shtetërore.

Pasi personat përgjegjës kanë marrë dijëni mbi këtë urdhër, eprorja direkte e ankueses znj. B.B, nuk ka qenë dakord me faktin që duhet të ishte pjesë e grupit të punës, duke e kundërshtuar aktin. Ndërkohë që veprimet nga grupi i punës nuk po kryheshin, ankuesja merr dijëni mbi revokimin e mëposhëm të urdhrin dhe për faktin që eprorja direkte e ka cilësuar këtë urdhër të ligjshëm si tendencioz, duke insistuar mbi faktin që nuk ishte ajo personi kompetent për të marrë objektin në dorëzim. Pas këtij kundërshtimi, ankuesja është ndeshur me situatë presioni dhe mungese etike profesionale nga eprorja direkte, e cila e shndërroi marrëdhënien hierarkike në çështje me karakter personal dhe ndaj saj janë ndërmarrë në mënyrë të njëpasnjëshme masa të

rënda, në tejkalim të kompetencave për masa të cilat nuk vendosen nga eprori direkt pa nisur fillimin e hetimit administrativ dhe duke ngarkuar me përgjegjësi ankuesen për akte të cilat nuk janë në kompetencë të saj, pasi vetë Bashkia Dimal, në përbërjen e saj ka drejtori të cilat i kanë kompetencat e ndara.

Specifikojmë se në Bashkinë Dimal asnjë punonjës nuk i kryen detyrat dhe kompetencat e tij me akte të posaçme për çdo lëvizje. Madje në librin e hyrje-daljes kishte punonjës të cilët as nuk e kishin shënuar emrin dhe orarin e ardhjes në institucion, në kundërshtim me rregullat e brendshme të pranuar të institucionit. Këto veprime të kryera janë haptazi me karakter diskriminues, duke u krijuar rregulla të ndryshme në heshtje vetëm për ankuesen, ndërsa ndaj punonjësve të tjerë nuk u konsiderua e arsyeshme të niste procedim për arsyet e daljes nga institucioni.

Për sa më sipër, ankuesja, për të gjitha veprimet/mosveprimet e kryera ndaj saj, është ndeshur me elementë të diskriminimit me karakter strukturor, duke e trajtuar ndryshe nga pjesa tjetër e punonjësve dhe në shkelle të hapur të ligjeve. Ankuesja është trajtuar në mënyrë të diferencuar me të gjithë punonjësit e administratës, ndërkohë që karakterizohej nga korrektësi mbi orarin e punës, shënimin e hyrje-daljeve, mungesat dhe kryerjen e detyrave brenda afateve ligjore.

Paligjshmëria e veprimeve të Bashkisë Dimal vijojnë në mënyrë të përsëritur, ku ankuesja me datë 06.09.2023 është njohur me shkresën me n.r. 2803, datë 06.09.2023 “Propozim për masë disiplinore” të iniciuar nga Inspektor Pritje, e në këtë propozim kërkohej masa disiplinore e përcaktuar paraprakisht “vërejtje me paralajmërim”, në kundërshtim me ligjin.

Sqarojmë se, propozimi për masë disiplinore ka ardhur mbi një ankesë në Platformën e Bashkëqeverisjes për programin e strehimit, ndërkohë që drejtorja përgjegjëse për programet e strehimit ka 1 drejtues dhe 2 specialistë strehimi, të cilët kanë marrë informacion mbi email-in dhe nuk janë proceduar me masë disiplinore nga institucioni si persona përgjegjës, madje parashtrimet e ankueses për delegimin e përgjegjësive personave kompetent nuk janë marrë parasysh nga strukturat përgjegjëse.

Pavarësisht kërkesave të ankueses për shtyrjen e afateve procedurale për shkak se nuk i ishin vënë në dispozicion aktet e dosjes, me datë 22.09.2023 zhvillohet mbledhja e komisionit disiplinor, pa u vënë në dispozicion plotësisht aktet dhe ndeshet në një situatë presioni psikologjik dhe një procedurë të paragjykuar që në nisje të saj. E drejta për tu dëgjuar gjatë 3 orëve në atë komision u shndërruan në orë gjykimi, ironie, sarkazme duke cenuar rëndë integritetin moral dhe profesional të saj.

Gjatë gjithë procedurës së nisur nga komisioni disiplinor ankuesja pretendon se dhe vetë faktet e paraqitura krijojnë dyshimin e arsyeshëm se kemi të bëjmë dhe me një tjetër formë të diskriminimit, në formën e “udhëzimit për të diskriminuar”.

Pavarësisht kërkesave të përsëritura për trajnimin e detyrueshëm në ASPA, sërish ankuesja është ndeshur përpara heshtjes administrative të organit publik, i cili me mosveprimet e tij nuk

ka përmbushur detyrimet ligjore për nëpunësin civil në periudhë prove, duke cenuar kështu të gjitha të drejtat legjitime deri në konfirmimin si nëpunës civil.

Ndërkohë në periudhën që ankuesja duhet të ishte për trajnim të detyrueshëm në ASPA e kanë paragjykuar për shkelje të etikës pa e hetuar më parë, punonjës të tjerë të bashkisë aktualisht e kanë përfunduar periudhën 2 javore të trajnimit, pavarësisht se kanë marrë gjatë muajve të fundit masa disiplinore. Veprime të tilla të kryera nga organi publik përbëjnë shkelje flagrante të ligjit, pasi ndaj ankueses është bërë një dallim nga të tjerët lidhur me trajnimet profesionale, duke u krijuar imazh i qartë që synimi i organit publik ka qenë drejtpërdrejtë largimi nga shërbimi civil i ankueses.

Ankuesja, ndryshe nga punonjësit e tjerë nuk ka ezauruar dhe lejen e zakonshme në shtator 2023, për arsye të një vizite rutinë që duhet të kryente për vajzën e mitur. Duke qenë se ankuesja prej 3 vitesh është diagnostikuar me një lloj artriti, prej së cilit i është krijuar vështirësi në ecje, nga shqetësimi për shëndetin e fëmijës për ta parandaluar në rast të trashëgimisë gjenetike, (sikurse është një sëmundje e përhapur në familjen e saj) e kishte të nevojshme të merrte një pjesë të mbetur të lejes së zakonshme prej 3 javësh. Ndërkohë të gjithë punonjësit e tjerë kishin përfitur lejen e zakonshme të vitit 2023 paraprakisht dhe për periudhë 1 mujore, në kundërshtim me ligjin.

Me datë 02.10.2023 ankuesja merr dijeneri për vendimin e Komisionit disiplinor me n.r. 2905/10, datë 27.09.2023 dhe Urdhrin e lirimimit nga shërbimi civil me nr. 3112, datë 29.09.2023. Të dy aktet të cilat sollën largimin nga detyra janë të pamotivuara, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe se nuk ka ardhur për ndonjë shkelje apo mos përmbushje të detyrës nga ana e ankueses. Lirimi nga shërbimi civil i ankueses ka ardhur si pasojë e veprimeve/mosveprimeve me karakter diskriminues dhe sipas një procedure të paragjykuar dhe me vendimmarrje të parapërcaktuar”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit në formën e diskriminimit strukturor, diskriminimit të drejtpërdrejtë, udhëzimit për të diskriminuar dhe viktimizimit, për shkak të detyrës, kundërshtimit të urdhrave të paligjshëm të eprorit direkt/titullarit të institucionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 13.11.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues informacion dhe shpjegime lidhur me:
 - Në objektin e ankesës keni pretenduar “për shkak të kundërshtimit të urdhrave të paligjshëm të eprorit”, ndërkohë në fund të ankesës, pika 1 keni pretenduar “për shkak të kundërshtimit të urdhrave të titullarit të institucionit”. Lidhur me këtë duhet të sqaroni: “eprori direkt apo titullari i institucionit” dhe të jepni prova të sakta dhe të qarta të këtij urdhri/ave të paligjshëm dhe kundërshtimeve tuaja.
 - Emrin e punonjësit/es me të cilin krahasohesh, lidhur me dhënien e masës disiplinore “vërejtje”.

- Kopje të kërkesave të përsëritura që keni bërë për trajnimin e detyrueshëm në ASPA.
- Informacion nëse i jeni drejtuar me ankesë Komisionit të Shërbimit Civil. Nëse po kopje të aktit.
- Informacion nëse i jeni drejtuar Gjykatës për largimin nga puna. Nëse po, kopje të padisë.

Subjekti ankues, me e-mail-in datë 10.11.2023, dërgoi informacionin e kërkuar dhe një kopje të kërkesë padisë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², në nenin 3/1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në informacionin e dërguar, subjekti ankues ka bashkëlidhur dhe kopje të dokumentacionit poshtëcituar:

- Kërkesë Padi datë 26.10.2023 kundër Bashkisë Dimal, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, Person i tretë: - Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt: *“1. Pranimin e Kërkesë Padisë. 2. Konstatimi i pavlefshërisë absolute nga Gjykata dhe/ose shfuqizimi tërësisht për shkak të paligjshmërisë me pasojë largimin nga puna dhe si nëpunës civil në periudhë prove për paditësen, konform nenit 108 a, i/ii/iii, 110.2 dhe 111, K. Proc. Administrative që lidhet me:”*

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

Në bazën ligjore ankuesja në mes të tjerash i është referuar dhe nenit 7.1, nenit 21 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në parashtrimet e saj në kërkesë padi, ankuesja në mes të tjerash ka cituar shprehimisht se: “...Lidhur me paligjshmërinë: pala paditëse, kundërshton të gjitha aktet e lartpërmendura, duke i konsideruar të paligjshme, të qëllimshme dhe diskriminuese pasi institucioni Bashkia Dimal:3. Veprimet/mosveprimet/aktet administrative janë haptazi me elemente diskriminuese, pasi në datë 30.08.2023 paditësja nuk ka qenë e vetmja punonjëse që ka qenë jashtë institucionit...”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, të depozituar si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për veprime diskriminuese të punëdhënësit për largimin e saj nga puna, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuseses.

Gjithashtu Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë me Njoftimin nr. 424, datë 30.10.2023, të protokolluar me tonën me nr. 1285, datë 15.11.2023, ka njoftuar Komisionerin për Mbrotjtjen nga Diskriminimi për padinë dhe aktet e znj. G.H kundër Bashkisë Dimal.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadi në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadiës. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadiës, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadiës”.

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: “Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njej të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo

kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: “Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 233, datë 27.10.2023, të znj. G.H, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj³.

Bazuar në nenin 36/4, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁴, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

³ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 129, datë 28.06.2022, nr. 29, datw 14.02.2023, të Komisionerit.

⁴ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 233, datë 27.10.2023, të paraqitur nga znj. G.H, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA